



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARE

Lindita NIKOLLA



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË  
TË SHTETIT PËR VITIN 2022

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, si institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar rëndësinë e funksionimit të këtij institucioni mbi bazë të garantimit të parimeve të pavarësisë, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, interesit të publikut, profesionalizmit, bashkëpunimit dhe transparencës;

Duke mbështetur dhe nxitur Kontrollin e Lartë të Shtetit për të punuar dhe kontribuar për një qeverisje të mirë nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit dhe abuzimeve në administrimin e pronës publike, rritjes së besimit të publikut dhe nxitjes së përdorimit me ekonomicitet, efikasitet dhe efikasitet të fondeve publike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikatat më të mira të BE-së e standardeve ndërkombëtare INTOSAI,

**Vlerëson veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2022 në drejtim të:**

Angazhimit për kryerjen e auditimeve në pajtueshmëri me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare të auditimit, duke bërë të mundur përfundimin dhe evadimin e 177 auditimeve të ushtruara në 205 subjekte në nivel vendor dhe qendror.

Adresimit të një numri total prej 5420 rekomandimesh për institucionet publike të audituara, nga të cilat 52 janë masa për përmirësime ligjore, 3283 masa organizative, 1047 masa disiplinore dhe administrative, 686 janë masa për efektet negative për shkak të parregullsive dhe 352 janë masa për shpërblim dëmi.

Vijimit të punës për rritjen e dobisë së rezultateve të auditimit, duke zbuluar parregullsi dhe shkelje financiare në fushën e menaxhimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit, administrimin e pronës shtetërore, koncesioneve, prokurimit publik, etj.

Intensifikimin e veprimtarisë së zbulimit dhe ndëshkimit të korrupsionit, duke paraqitur pranë organit të prokurorisë 4 kallëzime dhe indicie penale për 14 zyrtarë të niveleve të ndryshme, prej të cilëve 4 kanë mbajtur pozicione drejtuese.

Rritjes së besueshmërisë së publikut nëpërmjet trajtimit të 428 letrave dhe ankesave, nga të cilat pjesa kryesore u adresohet problematikave që lidhen me privatizimin dhe kthimin e pronës.

Modernizimit të aktivitetit auditues dhe trajnimin e audituesve të KLSH-së, të cilët në fund të vitit 2022 rezultojnë të kenë siguruar një mesatare prej 27 ditë trajnimi/auditues nëpërmjet realizimit të 3905 ditë trajnimi gjithsej. Në total për vitin 2022 janë zhvilluar 280 aktivitete trajnuese, prej të cilave 88 aktivitete trajnuese të fokusuara në zgjerimin e njohurive mbi Standardet e Auditimit të INTOSAI-t, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, manualët e auditimit, 34 aktivitete në çështje sensitive si prokurimet publike, PPP dhe koncesionet, etj.

Intensifikimit të bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet finalizimit të 2 marrëveshjeve bilaterale, përkatësisht me SAI-n e Norvegjisë dhe atë të Maqedonisë së Veriut, me theks në fushën e auditimit të performancës, mjedisit dhe IT-së.

Angazhimit në raportimin për procesin e integritetit në Komisionin Europian në kuadër të Kapitullit 32, "Kontrolli Financiar".

Hartimit dhe miratimit të Strategjisë së Komunikimit 2022-2025 për të cilën është asistuar nga ekspertët e SIGMA-s.

**Kuvendi kërkon që Kontrolli i Lartë i Shtetit për vitin 2023 të vazhdojë punën në këto drejtime:**

1. Të rrisë ekspertizën profesionale në veprimtarinë audituese mbi fusha të tilla si: qëndrueshmëria e financave publike, efektiviteti dhe efienca e menaxhimit të programeve të qeverisjes, kryesisht në ato me partneritet publik-privat, zhvillimet dixhitale, etj.

2. Të programojë periodikisht auditime në të gjitha institucionet e pavarura që raportojnë në Kuvendin e Shqipërisë dhe gjetjet e këtyre auditimeve t'ua paraqesë komisioneve parlamentare bazuar edhe në analizën e risqeve të tyre.

3. Të nxisë auditimet e teknologjisë dhe informacionit dhe auditimet e mjedisit për sa u takon fushave që lidhen me sulmet kibernetike, ndryshimet klimatike, menaxhimin e mbetjeve dhe financimin e mbrojtjes së mjedisit.

4. Të përmirësojë cilësinë e auditimeve duke iu përgjigjur në mënyrë të vazhdueshme zhvillimeve të Standardeve Profesionale të Auditimit të Jashtëm Publik dhe rregulloreve të auditimit për të ndikuar në forcimin e sistemit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, si dhe në ndihmë të zhvillimit dhe forcimit të institucioneve publike.

5. Të identifikojë institucionet që rezultojnë me nivelin më të ulët të treguesit të zbatimit të rekomandimeve, si dhe të nxisë mekanizmat e koordinimit me Kuvendin dhe qeverinë, me qëllim përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të financave publike.

6. Të ndjekë me përparësi realizimin e aktiviteteve në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike të institucionit, të parashikuara në Strategjinë e Zhvillimit Institucional të KLSH-së për periudhën 2023-2027, hartuar në bashkëpunim me Iniciativën për Zhvillim të INTOSAI (IDI) dhe ekspertizën e SAI-t të Norvegjisë.

7. Të orientojë punën audituese në lidhje me programimin buxhetor vjetor dhe afatmesëm, në funksion të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 dhe përdorimin efektiv dhe eficient të fondeve publike.

8. Të përcaktojë mënyrën dhe metodologjinë e përlllogaritjes së dëmit ekonomik që i shkaktohet buxhetit të shtetit referuar praktikave më të mira dhe ta publikojë atë në faqen zyrtare të institucionit.

9. Të rrisë transparencën nëpërmjet vijimit të publikimit në faqen zyrtare të institucionit të raporteve të auditimit, të raporteve të paraqitura nga KLSH-ja në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe të buletinit përmbledhës të KLSH-së.

10. Të promovojë rolin e institucionit nëpërmjet shtimit të mjeteve të komunikimit me palët e interesit, organizatat e shoqërisë civile dhe botën akademike, me qëllim forcimin e besimit të publikut tek pavarësia e institucionit.

Miraturar në datën 20.7.2023